

VENDIM
Nr. 96, datë 4.2.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË DEKLARIMIT,
RUAJTJES, REGJISTRIMIT DHE PAAFTËSIMIT PËR ARMËT E KOLEKSIONIT**

(Ndryshuar me vendimin nr. 270, datë 12.5.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 45, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në strukturën përgjegjëse të policisë, armët e koleksionit të kategorive “A”, “B”, “C” e “D”, që plotësojnë kriteret për t’u quajtur armë zjarri, regjistrohen njëjloj si armët e tjera, me të dhënat e numrit të serisë, tipit, kalibrit dhe fabrikën e prodhimit.

2. Armët e koleksionit ndahen në tri kategori dhe, që të quhen të tilla, duhet të plotësojnë njëren nga këto kushte:

a) Të jenë armë të prodhuara, së paku, 50 vjet para datës së kërkesës për pajisje me autorizim;

b) Të jenë armë të cilat kanë kryer procedurat e regjistrimit si objekte të deklaruara pasuri kulturore pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK);

c) Çdo armë tjetër që ka vlera të rralla, ose që lidhet me ndonjë figurë, periudhë apo ngjarje historike.

3. Personi fizik dhe juridik, për regjistrimin e armëve të koleksionit ose muzeut, që nuk janë paaftësuar/çaktivizuar, pajiset me autorizim për koleksionim armësh nga komisioni qendror i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e neneve 34 e 35, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, si dhe kushtet e sigurisë së objektit, kriteret e sigurisë së armëve në vendin e koleksionimit ose muzeut, sipas përcaktimit të akteve nënligjore.

3/1. Për armët e koleksionit të deklaruara “pasuri kulturore”, të cilat janë të vjedhura ose të humbura, bëhet regjistrimi edhe në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, sipas procedurave dhe mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Për armët e paaftësuar, personi fizik ose juridik paraqet online, në portalin unik qeveritar, e-Albania dokumentin e lëshuar nga subjekti i licencuar për paaftësimin e armëve, të cilat janë vulosur me shkronjën “D”.

5. Personi fizik dhe juridik, për të marrë autorizimin si koleksionist ose person i autorizuar për administrimin e armëve në muze, paraqet kërkesën përmes platformës online, dokumentacionin dhe listën me armët që zotëron, pranë IKRTK-së, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Lista e armëve të jetë e ndarë në armë që janë të paaftësuar dhe armë që nuk janë paaftësuar. Për armët që nuk janë paaftësuar jepen të dhënat e armëve, ku përshkruhet tipi, kalibri, modeli dhe numri i serisë së armës.

7. Komisioni, para se të pajisë me autorizim për koleksionim armësh subjektin fizik a juridik, për armët e paraqitura, ushtron kontroll për saktësinë e të dhënave dhe, më pas, lëshon autorizimin për koleksionist armësh, ose si person i autorizuar për administrimin e armëve në muze.

8. Regjistrimi i armëve të koleksionit dhe atyre të muzeut bëhet nga sektori përkatës i policisë vendore, në regjistrin e armëve, sipas akteve nënligjore.

9. Armët e koleksionit dhe armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, në përputhje me rregullat e ndryshimit të pronësisë së armëve, sa u përket mbajtjes, mbrojtjes, vlerësimit, administrimit dhe tjetërsimit të pronësisë së tyre.

10. Në rastet kur koleksionisti kërkon të blejë armë, më parë ai paraqet armën që kërkon të blejë, të

dhënat për armën, subjektin ku do të blihet dhe arsyen e vlerat e armës. Blerja dhe shitja e armëve të koleksionit jashtë vendit bëhet me autorizim të policisë.

10/1 Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore, importi ose eksporti i tyre kryhet përmes lëshimit të licencave të import/eksportit të pasurive kulturore.

Shitblerja e armëve të koleksionit të deklaruar pasuri kulturore i nënshtrohet procedurave të parashikuara në vendimin nr. 199, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shqyrtimin ose anulimin e licencës, tarifat e kërkesës dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore.

11. Lëvizja dhe transportimi i armëve të koleksionit bëhet me kërkesë të motivuar. *Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore lëvizja dhe transportimi bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.*

12. Titullari i policisë vendore autorizon transportin e armëve të koleksionit, me qëllim riparimi, provash në poligon ose ekspozimi. *Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore kërkohet autorizimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.*

13. Autorizimi i mësipërm nuk mund të lëshohet për më shumë se 6 (gjashtë) armë njëherësh.

14. *Çaktivizimi/paafësimi i armëve të koleksionit kryhet me të njëjtën procedurë dhe të njëjtat kritere si edhe për armët e tjera. Çaktivizimi/paafësimi bëhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për çaktivizimin/paafësimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.*

15. Paafësimi i përhershëm/çaktivizimi i armës së zjarrit bëhet sipas njërës prej procedurave teknike të mëposhtme:

a) Foleja e fishekut të ketë tri vrima, të vendosura në kënd 120 gradë, me diametër të barabartë me kalibrin e tytës së armës së zjarrit, ose foleja e fishekut të jetë e mbyllur me sferë metalike dhe me saldim;

b) Tyta e armës së zjarrit të jetë e mbyllur (me metal të shkrirë) nëpër tërë gjatësinë e tytës;

c) Tyta e armës të jetë e prerë për së gjati, nëpër tërë gjatësinë e saj, me prerje të gjerë, së paku 5 (pesë) milimetra, e cila fillon nga foleja e fishekut;

ç) Për armët me mulli (revolver) paafësimi i tytës bëhet njëloj si armët e shkronjës “a”, “b”, dhe “c”, ndërsa mulliri mbyllet me saldim.

16. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama